



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## **Komunikatë**

**17.07.2013**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 35-të, në të cilën mbledhje emëroi Komisionet Komunale Zgjedhore, dhe miratoi Planin Operacional të QNR-së. Alban Krasniqi, e informoi KQZ-në me shqyrtimin dhe revidimet që janë bërë në KOZ. Betim Gjoshi, tha se duhet kushtuar rëndësi afateve ligjore në mënyrë që planet të realizohen me kohë. Zgjedhjet janë një operacion që nuk ndodhin shpesh, për këtë edhe duhet të zbatohen më shpejt. Organizimi i punës së QNR-së, duhet të kryehet mire, dhe me vëmendje. Burim Ahmetaj, koordinator i QNR-së, tha se prioritet ka procesimi i materialit. Deri në 70% të punës, ia kemi kushtuar procesimit të materialit për Kryetar Komune, dhe 30% për Asamble istët. Kemi parashiku që të punojmë në tri ndërrime. Për 10 ditë, do të përpiqemi që ta procesojmë materialin zgjedhor. Florian Dushi, tha se, kjo kohë e përcaktuar në planin operacional të QNR-së, është e parprueshme sepse, unë mendoj që afati i shpalljes së rezultateve duhet të jetë obligim i KQZ-së. Shtatë ditë, janë të mjaftueshme për t'i shpallë rezultatet preliminare. Insitoh në këtë mbledhje që KQZ, qysh tash ta caktoj datën se kur rezultatet duhet të jenë të gatshme. Në këtë mbledhje, KQZ, kërkoi nga Koordinator i QNR-së që ta përfshijë në Planin Operacionale të QNR-së, afatin për shpalljen e rezultateve për Kryetar të Komunave, i cili duhet të jetë jo më më vonë se shtatë (7) ditë pas ditës së zgjedhjeve, ndërsa për Kuvende Komunale, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë. KQZ pastaj, e miratoi Planin Operacional të QNR-së.

Gjatë kësaj mbledhje, KQZ i shyrtoi emërimet e KKZ-ve për zgjedhjet lokale të 03 Nëntorit 2013. Anëtarët e KQZ-së, në bazë të rekomandimeve të KOZ-it, emëroi anëtarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore për 34 komuna: Deçan, Gjakovë, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Lipjan, Vushtrri, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillugë, Parteshë dhe Kllokot.

Në fund të mbledhjes, KQZ kërkoi nga Sekretariati që, për çdo ndryshim dhe plotësim në Listat e anëtareve të KKZ-ve (në pajtim me afatin ligjor), të njoftohet KQZ.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---